



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 6, datë 03.02.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe VKM nr. 958, date 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Gjirrokastër me:

Drejtues Ligjor Bashkim Tola

Drejtues Teknik Besnik Kocaqi

2. Operatori Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Gjirrokastër autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik

Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Gjirrokastër.
4. Kjo liçencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 52, datë 06.07.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 06, DATË 03.02.2017 "PËR
LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR"**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër sh.a. për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatohet se:

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 06, datë 03.02.2017, "Për licencimin e sh.a Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër";
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër ka aplikuar me anë të shkreses nr.976 prot. datë 21.06.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor;
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër sh.a. plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit mbi ndryshimin e drejtuesit ligjor, konkretisht:
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Drejtuesi ligjor plotëson kriteret e parashikuara në Rregulloren e Licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr. 06, datë 03.02.2017 "Për licencimin e sh.a. Ujësjetës Kanalizime Gjirokastrë " bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor Dhimitri Kristidhi"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 19, datë 19.04.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 6, DATË 03.02.2017, "PËR LICENCIMIN E SH.A. UJËSJELLËS KANALIZIME
GJIROKASTËR", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence"(VKM nr.958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 19.04.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër sh.a. (**UK Gjirokastër**) për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik.",

Vëren se:

1. Shoqëria UK Gjirokastër me shkresën nr. 142 prot. datë 12.02.2019, me lëndë "Dërgojmë të dhënat mbi ndryshimin e drejtuesit teknik" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Gjirokastër për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.
3. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Gjirokastër sh.a. plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi profilin e edukimit.
4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) ERRU ka licencuar shoqërinë UK Gjirokastrë me vendimin nr. 06, datë 03.02.2017, “Për licencimin e sh. a Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë”, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura;
 - b) ERRU me vendimin nr. 52, datë 06.07.2018, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 06, datë 03.02.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë”, i ndryshuar, ka rinovuar licencën e UK Gjirokastrë me drejtuesin ligjor z. Dhimitri Kristidhi.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Gjirokastrë sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Gjirokastrë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 06, datë 03.02.2017, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë”, i ndryshuar bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues Teknik Bashkim Tola”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.57, datë 28.10.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 6, DATË 03.02.2017, “PËR LICENCIMIN E SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME
GJIROKASTËR”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 03.02.2017 “Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër”,

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër (**UK Gjirokastër**) me shkresën nr. 983 prot. datë 09.09.2019, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Gjirokastër për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Gjirokastër me vendimin nr. 6, datë 03.02.2017 “Për licencimin e sh.a Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër”, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Gjirokastër sh.a. z. Gentian Llogo, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi dega financë kontabilitet si dhe master për financë bankë.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Gjirokastër sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Gjirokastër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 6, datë 03.02.2017 “Për licencimin e sh.a Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor z. Gentian Llogo”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI